



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, qershor 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ariana Berisha-Rexhëbeqaj udhëheqëse e ekipit, Hysen Boqolli dhe Arian Zenelaj anëtarë të ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.


## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja .....	27
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	30

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur sipas kërkesave të kornizës për raportim financiar përderisa kishte keq klasifikim të shpenzimeve.

Komuna ka të vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, megjithatë nevojiten veprime shtesë për përmirësim të mëtejshëm të menaxhimit më të mire sidomos të shpenzimeve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë kategoria e investimeve kapitale, menaxhimi i pasurive, menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshmeve.

Komuna nuk kishte ndjekur ndonjë proces formal për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve si dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e tyre. Kjo ka ndikuar që vetëm një pjesë (33%)<sup>1</sup> e rekomandimeve të zbatohen dhe të përsëriten mangësitë e njëjta në disa fusha.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm<sup>2</sup>

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

#### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Për më tepër shih seksioni 3 "Progresi në zbatimin e rekomandimeve"

<sup>2</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Mamushës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes planifikimit buxhetor dhe vendimeve të Kryetarit, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 150,341€ në kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre pagesat në vlerë prej 117,384€ ishin të buxhetuara dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale edhe pse këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime dhe pagesat në vlerë prej 32,957€ ishin paguar me vendime të Kryetarit nga kategoritë jo adekuate. Më gjerësisht shih tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni jonë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Mamushës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ëebfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë investimet kapitale, menaxhimi i pasurive, subvencionet dhe transferet si dhe menaxhimi i burimeve njerëzore. Kontrollle shtesë duhen të aplikohen edhe tek mbledhja e të hyrave, pasi që kjo është duke ndikuar në rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme.

#### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>3</sup>	2019 Realizimi	2019 Realizimi%	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>2,073,560</b>	<b>2,120,684</b>	<b>1,966,586</b>	<b>93%</b>	<b>2,265,753</b>	<b>1,595,791</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,989,274	1,989,274	1,880,386	95%	2,171,303	1,517,996
Huamarrja	13,217	-	-	0%	-	-
Të bartura nga viti paraprak <sup>4</sup> -	-	59,846	59,844	100%	67,857	71,902
Të hyrat vetjake <sup>5</sup>	71,069	71,069	25,969	37%	17,103	5,893
Donacionet e jashtme	-	495	387	78%	9,490	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 47,124€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave nga viti paraprak 59,846€, ndërsa në anën tjetër mos alokimi i huamarrjes në vlerë prej 13,217€ në buxhetin final nga MF pasi që Thesari kishte bërë pagesat direkt me vendimin e Ministrisë së Financave. Huamarrja ishte planifikuar në fushën e shëndetësisë, për furnizim me barna esenciale në QMF.

<sup>3</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>4</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>5</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.



Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 1,966,586, me një ulje në realizim për 3% krahasuar me vitin 2018 (96%). Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	2019 Realizimi%	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>2,073,560</b>	<b>2,120,684</b>	<b>1,966,586</b>	<b>93%</b>	<b>2,265,753</b>	<b>1,595,791</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,057,185	1,057,185	993,287	94%	897,586	834,645
Mallrat dhe Shërbimet	267,426	254,227	253,313	100%	218,930	178,130
Shërbimet komunale	30,212	30,212	30,178	100%	24,037	22,819
Subvencionet dhe Transferet	27,844	27,844	27,835	100%	406,036	6,350
Investimet Kapitale	690,893	751,216	661,973	88%	719,164	553,847

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për 60,323€. Pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj kategori ishte shpenzuar në fund vit dhe kjo kishte ndodhur si rezultat i vonesave në iniciimin e prokurimeve dhe nënshkrimin e kontratave si dhe vonesave për shkak të ankesave në procedurat e prokurimit.

### Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

#### Gjetja

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, Komuna e Mamushës gjatë vitit 2019 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 150,341€ nga kategoritë ekonomike joadekuate. Këto pagesa ishin në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 2005/08 Klasifikimi Ekonomik i Shpenzimeve (i plotësuar/ndryshuar prill 2009).

- Komuna nga kategoria e investimeve kapitale kishte realizuar pagesa në vlerë totale prej 117,384€, për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Nga dy projektet kapitale sipas Ligjit të buxhetit 2019, "Projekte për bashkëfinancim me donatorët" dhe "Bashkëfinancimi i projekteve me

donatoret”<sup>6</sup>, komuna ka realizuar dy pagesa (të regjistruara në kodin ekonomik 32055, implementimi i reformës) në vlerë totale prej 117,384€ për kujdesin shëndetësor, social, edukativ, trajnim të stafit shëndetësor bazuar në marrëveshjen bashkëpunimit dhe financimit me OJQ<sup>7</sup>. Komuna këtë vendim e mbështet me mungesën e buxhetit për kategorinë adekuate.

Shkak për këtë situatë ishin kufizimet buxhetore për planifikimin e fondeve të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e nevojshme për mallrave dhe shërbimeve me ç`rast komuna gabimisht ka planifikuar mbulimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve nga investimet publike.

- Gjithashtu pagesat prej 32,957€ janë realizuar dhe prezantuar si shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbime, edhe pse për nga natyra këto pagesa i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Pagesat ishin realizuar me vendimin e kryetarit për kompensimin e punonjësve apo pagesave jubilarë, si në vijim:
  - Pagat e gjashtë zyrtarëve të angazhuar si stafi politik në vlerë 22,339€, janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve duke i regjistruar dhe prezantuar si shërbime të ndryshme intelektuale (kodi ekonomik 13440) dhe shpenzime tjera kontraktuese (kodi ekonomik 13460). Kjo ka ndodhur për arsye se në organogramin e komunës së Mamushës nuk janë paraparë punonjës të stafit mbështetës të Kryetarit, Nënkryetarit dhe Kryesuesit të komunës;
  - Pagat në vlerë 5,413€, e një punonjësi në shkollën fillore “Anadolu” për periudhën shkurt-dhjetor 2017, me vendim të Kryetarit të Komunës nr.112/19 janë paguar nga mallrat dhe shërbimet, konkretisht (kodi ekonomik 13410). Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte mjete dhe numër të buxhetuar të stafit, edhe pse kishte bërë përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim; dhe

<sup>6</sup> “Projekti për bashkëfinancim me donatoret” -48840, mjetet e planifikuar në vlerë 60,000€ për vitin 2019 (nga 10-BKT), për programin planifikimi dhe zhvillimi ekonomik, ndërsa në total për 2019-2021 (sipas KASH 3\*60,000€), 180,000€. Dhe nga programi 73850- shërbime shëndetësore primare, janë planifikuar mjete në vlerë 60,000€ (nga 10-BKT) për vitin 2019, sipas projektit “Bashkëfinancim i projekteve me donatoret” -48952, ndërsa në total për 2019-2021 (sipas KASH-3\*60,000€), 180,000€.

<sup>7</sup> Vlera e këtij projekti është 170,519.92€ ku komuna participon me 142,099.92€ dhe OJQ 28,420€ (Human Care), bazuar në thirrjen publike me 30.09.2019.

- o Nga thesari me vendim të Kryetarit në vlerë 5,205€, janë ekzekutuar paga jubilarë nga kategoria e mallrave dhe shërbimet duke i evidentuar dhe prezantuar si shërbime të arsimit dhe trajnimit në kodin ekonomik 13410. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, ku janë realizuar pagesa që kanë rezultuar me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve për këto dy kategori.

**Ndikimi**

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezultojnë me prezantimin e gabuara të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare. Raportimi jo i drejtë i të dhënave për klasifikimin e shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV apo ndikon në vendimmarrjen e menaxhmentit.

**Rekomandimi B1**

Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejtë të shpenzimeve publike në PFV.

**2.1.1 Të hyrat**

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mamushës në vitin 2019 ishin në vlerë 60,688€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat administrative, taksat rrugore, participimet etj.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	71,069	71,069	60,688	85%	56,177	42,798
<b>Totali</b>	<b>71,069</b>	<b>71,069</b>	<b>60,688</b>	<b>85%</b>	<b>56,177</b>	<b>42,798</b>

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna ka pranuar të hyra nga dënimet e policisë dhe gjobat në vlerë 9,295€.

---

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 1,057,185€, i cili ishte i shpenzuar 94%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 156 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 148<sup>8</sup>. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 18 të rinj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 36,029€, si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

### Çështja A1 – Dobësi në procesin e rekrutimit

#### Gjetja

Bazuar në rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, neni 29 paragrafi 1, parasheh që: “KPSHC<sup>9</sup> duhet të përgatisë një listë të shkurtër prej së paku tre kandidatëve. Nëse paneli nuk mund të identifikojë së paku tre kandidatë adekuat për përfshirje në listën e shkurtër, pozita duhet të rishpallet”.

Në konkursin e dt. 29.07.2019 për pozitën “Zyrtar për buxhet dhe financa 2” (e shpallur për rekrutim për katër zyrtar për njësi të ndryshme<sup>10</sup> në kuadër të komunës) mes tjerash kërkohej si kritere “Minimumi dy vite përvojë pune profesionale” dhe “çertifikata që nuk janë nën hetime”. Poashtu, është vendosura paragrafi se “Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim”. Në këtë konkurs identifikua si në vijim:

- Njëri nga tre konkurrentët e listës së ngushtë (për rekrutim të ZBF në zyrën e kryetarit dhe ai për sektorin për infrastrukturë rrugore), kishte një vit e gjysmë përvojë pune; dhe
- Në tri nga katër raste të pranuarit/punësuarit sipas këtij konkursi nuk kishin sjellë çertifikatën që nuk janë nën hetime. Pas identifikimit nga ZKA, zyra e personelit i ka kërkuar dhe këto çertifikata janë pranuar me dt.12.12.2019.

Sipas deklaratave të zyrtarëve komunal shkak i kësaj ishte mungesa e kandidatëve të kualifikuar, mos përfillja e kritereve nga komisioni i përzgjedhës si dhe të zyrës së personelit për të kërkuar dëshmitë sipas konkursit.

---

<sup>8</sup> Në këtë numër nuk janë përfshirë 19 këshilltarët komunal.

<sup>9</sup> KPSHC- komisioni për përzgjedhjen e shërbyesve civil

<sup>10</sup> Drejtoria për shërbime publike dy (një për sektorin për bujqësi, një për sektorin për infrastrukturë rrugore) një për drejtorinë për buxhet dhe financa dhe një në zyrën e Kryetarit të komunës

---

---

**Ndikimi** Mangësitë e identifikuara mund të rezultojnë me përzgjedhjen e kandidatëve jo kompetent. Kjo rrit rrezikun që procesi i rekrutimit të vihet në diskutim apo si proces të kontestohet nga të interesuarit që nuk ju është ofruar shansi për të aplikuar për shkak të kriterëve të vendosur që janë anashkaluar me rastin e përzgjedhjes.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit respektohen të gjitha kriteret e vendosura në konkurs. Në të kundërtën, në mungesë të konkurrentëve të rishpallet konkursi.

### 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe shërbime komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 254,227€, prej tyre ishin shpenzuar 253,313€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, furnizime mjekësore, reklama, etj. Kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 79,738€ si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Përveç keq klasifikimit të shpenzimeve të paraqitur tek theksimi i çështjes, nuk kemi çështje tjera në këtë fushë.

Përderisa buxheti final për shërbime komunale ishte 30,212€ i cili ishte shpenzuar 100%.

### 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 27,844€, prej tyre ishin shpenzuar 27,835€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e lehonave dhe për entitetet jo publike. Kemi testuar gjashtë mostra për teste substanciale në vlerë 7,539€ si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

## Çështja A2 – Mangësi në financimin e OJQ-ve

**Gjetja** Bazuar në Rregulloren e MF-së Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 2 paragrafi 6 është paraparë: “që ofruesi i mbështetjes financiare lidhë kontratë me OJQ-në”.

Komuna nuk kishte nënshkruar kontrata me përfaqësuesit e dy<sup>11</sup> OJQ-vë përfituese të subvencionit dhe mbështetjes financiare në vlerë 4,000€ (në fushën e Sportit-Rinis-Kulturës), sipas thirrjes publike me nr. 016/2019 të dt. 07.11.2019.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së përvojës paraprake, pasi që komuna ka filluar ta aplikoj këtë rregullore për herë të parë këtë vit.

**Ndikimi** Mungesa e kontratës me OJQ-në përfituese ndikon në mos respektimin e standardit themelore të financimit, monitorimin, publikimin dhe raportimin e subvencionit. Mos aplikimi i kriterëve të përgjithshme të parapara në rregullore, rrezikon që mjetet e dhëna për subvencione të mos arrij qëllimin apo mund t'i ekspozohet edhe rrezikut për përdorimin e parregullt të parasë publike.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të siguroj që në thirrjet publike për subvencionimin e OJQ-ve të vendosen kriteret e përgjithshme obligative dhe të lidh kontrata me OJQ-të e përzgjedhura si përfituesi.

### 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 751,216€, prej tyre ishin shpenzuar 661,973€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me objektet arsimore, pajisje të teknologjisë informative, pajisje speciale mjekësore dhe pajisje tjera etj. Kemi testuar 41 mostra për teste substanciale në vlerë 556,031€, si dhe 14 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

<sup>11</sup> Shuma e subvencionimit është në vlerë prej 4,000€ për dy pagesa nga 2,000€ (Pagesa e OJQ-se Mamusha Gonul Eli Demegi dhe Pagesa shkolla e futbollit e OJQ-se Mamusha Sport).

---

### Çështja A3 – Realizimi i punimeve në prona private

**Gjetja** Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, përkatësisht neni 17 paragrafi 1 përcakton se: “Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike.

Gjatë ekzaminimit fizik (të shoqëruar nga menaxheri i kontratës dhe organi mbikëqyrës) të punëve të kryera sipas kontratës “Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe kanalizimeve në Mamushë”, pagesa e certifikuar në vlerë 46,477€ (raporti i pranimit Nr.03/19 nga menaxheri i kontratës dhe situacionin –VI nga organit mbikëqyrës), investimi përkatësisht kubëzimi i rrugëve për këtë situacion është realizuar në prona private duke përfshirë edhe ato të cilat sipas dëshmimeve janë rrugë të mbyllura brenda oborreve të shtëpive dhe të njëjtat nuk janë të shfrytëzueshme dhe në interes të gjerë për qytetarët e Komunës së Mamushës.

Shkaqet e realizimit të punimeve në prona private janë mungesa e njohurive mbi hapat të cilat duhet të ndërmarr komuna me rastin e realizimit të projekteve të tilla.

**Ndikimi** Investimet e parasë publike në pronat private nuk rezultojnë me përfitimin publik në interes të qytetarëve. Ky investim i ekspozohet rrezikut të dëmtimit apo edhe të ndalimit për shfrytëzim, ngaqë nuk ka ndonjë pëlqim formal paraprak për lejimin e realizimit të projektit nga ana e pronareve të këtyre tokave.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që para se të realizoj punimet për projektet të cilat shtrihen përgjatë parcelave të cilat janë nën pronësi private, të ndërmarr veprimet e duhura ligjore për shpronësimin e parcelave përkatëse të cilat komuna i sheh në interes të publikut.

---

## Çështja B2 - Tejkalimi i pozicioneve të paramasës së kontraktuar

### Gjetja

Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik përkatësisht paragrafi 61.20 pikat g dhe h - Funksionet e Menaxherit të Projektit janë: “Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës” dhe “T’i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin”.

Nga auditimi i 41 pagesave kemi identifikuar se në tri raste<sup>12</sup> komuna kishte realizuar pagesa të situacioneve në vlerë prej 11,066€ për pozicionet të cilat ishin tejkualuar krahas paramasës së kontraktuar por pa tejkualuar vlerën totale të kontratës. Pra, Organi mbikëqyrës përkatësisht menaxheri i kontratës nuk kishte respektuar paramasën dhe parallogarinë si aneks i kontratës bazë. I njëjti nuk kishte respektuar procedurat ligjore me rastin e ndryshimit-tejkalimit të pozicioneve pasi që nuk ishin kërkuar aprovim për ndryshimin e pozicioneve nga ana e menaxherit të prokurimit.

Planifikimi dhe hartimi jo-adekuat i projekteve nga ana e autoritetit kontraktues, ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda paramasës së kontraktuar. Gjithashtu, mungesa e përgjegjësis nga ana e Menaxherit të projektit ka bërë që mos të ndiqen procedurat përkatëse ligjore me rastin e tejkualimit të pozicioneve.

### Ndikimi

Tejkalimi i pozicioneve të përcaktuara paraprakisht në marrëveshje kontraktuale pa ndjekur procedurat ligjore përbën shkelje të kontratës dhe si e tillë rrit rrezikun që Operatori Ekonomik të mos kryej punët sipas standardeve dhe cilësisë së përcaktuar në paramasë.

### Rekomandimi B2

Kryetari përmes Menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv, gjithashtu nuk duhet të lejohen tejkualime-ndryshime të pozicioneve të paramasave paraprakisht të kontraktuara, sepse çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës.

---

<sup>12</sup> Riparimi i parqeve dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Mamushë – Renovimi i parkut tek gjimnazi dhe shkolla fillore LOT 1, vlera 8,895.20€; Riparimi i parqeve dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Mamushë –Riparimi i parqeve dhe shportave metalike për mbeturina LOT 3, vlera 27,834.41€; Riparimi i parqeve dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Mamushë –Mbjellja e drunjëve në komunën e Mamushës LOT 3, vlera 12,389€



---

## Çështja A4 - Parregullsi në bartjen e mjeteve nga një projekt në tjetrin

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përkatësisht neni 30 paragrafi 5 "Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij neni, Kryetari i Komunës, pas marrjes së miratimit nga Kuvendi Komunal, mund të bëjë bartjen e një shume në një ndarje buxhetore të komunës në një ndarje tjetër buxhetore të komunës".

Në katër<sup>13</sup> nga 41 mostra e audituar, komuna në mungesë të fondeve të mjaftueshme të buxhetuara ka realizuar pagesa në vlerë prej 16,088€ duke i shfrytëzuar mjetet e projekteve tjera<sup>14</sup>. Këto pagesa ishin pa siguruar aprovimin paraprak të Asamblesë Komunale për transferin e rregullt të ndarjeve buxhetore. Realizimi i pagesave është siguruar nga tepricat buxhetore të projekteve tjera vetëm me vendimin e Kryetarit të Komunës.

Shkaku i mosrespektimit të procedurës është planifikimi jo adekuat i projekteve, neglizhenca si dhe koha e limituar për të ndjekur këtë procedurë, pasi këto pagesa janë kryer në fund të vitit.

**Ndikimi** Mos përfillja e procedurës ligjore ndikon në uljen e transparencës për të arsyetuar vlefshmërinë e nevojës për transfer të mjeteve, me qëllim të qeverisjes sa më të mirë të burimeve në dispozicion dhe destinimin e tyre në të mirën e qytetarëve.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë që para marrjes së vendimit për bartje të shumave nga një projekt në tjetrin, duhet miratimi paraprak nga Kuvendi Komunal.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 735,245€, pasurive jokapitale është 26,020€, si dhe e stoqeve 15,463€. Kemi testuar 54 mostra për teste substanciale në vlerë 418,005€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

<sup>13</sup> Paguar për: Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe kanalizimeve në Mamushë, në vlerë 11,599€, 685.16€, 2,599.26€ dhe 1,204.88€.

<sup>14</sup> Paguar nga: Kodi projektit 48944, Ura dhe muri mbrojtës i Lumit Topllua 11,599€; Kodi projektit 89854, Hapja e pusit (685.16€); Kodi projektit 48943, Projekti Pyllëzimit në zonat e erozionit 2,599.26€ dhe Kodi projektit 45810, Ndërtimi i garazhës për automjete te zjarrfikësve 1,204.88€.

---

## Çështja A5 – Dobësi në regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë

### Gjetja

Neni 6 pika 3 i Rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare përcakton që “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria”. Neni 19 pika 4.7 përcakton që raporti i inventarizimit duhet të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Po ashtu, edhe neni 20 përcakton se: “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar njësojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës”. Lidhur me menaxhimin e pasurive kemi identifikuar si në vijim:

- Regjistrat e pasurisë nuk konsiderohen të plotë pasi komuna ka filluar procesin e regjistrimit të pasurive në fillim të vitit 2019 për pasurinë e blerë vetëm gjatë këtij viti, pasuria tjetër në posedim të komunës nga vitet e mëparshme ende nuk është regjistruar. Po ashtu, në nëntë raste nga 54 mostrat e testuara, pasuria e blerë gjatë këtij viti në vlerë 12,916€, nuk është evidentuar në regjistrat kontabël. Në këta regjistra nuk janë të përfshirë as tokat, objektet (shkolla, QMF, objekti komunal etj.) që komuna i posedon.

Ndërrimi i zyrtarit të pasurisë e në disa periudha edhe mungesa e tij, si dhe mos gatishmëria e menaxhmentit ka ndikuar që pasuria të mos regjistrohen në regjistrat adekuat apo kjo çështje të bartet vit pas viti;

- Komisioni për inventarizim edhe pse kishte dorëzuar raportin për inventarizimin e pasurisë nuk kishte bërë harmonizimin e të dhënave nga raporti i inventarizimit me evidencat e zyrtarit të pasurisë; si dhe
- Pas përfundimit të vitit komuna kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurive si nevojë e dalë nga raporti i inventarizimit të pasurive jo financiare, i cili nuk kishte arritur të përfundojë punën me kohë.

Shkaku i mos harmonizimit të regjistrave ishte mungesa e informatave se një gjë e tillë duhet të ndodhë dhe mungesa e evidencave apo regjistrave të pasurisë nga vitet paraprake ka pamundësuar harmonizimin përkatës, gjithashtu neglizhenca e menaxhmentit përgjegjës për aprovimin me kohë të komisionit për vlerësim të pasurive.

---

**Ndikimi** Regjistrimi i pasurive të blera vetëm gjatë këtij viti (edhe atë jo i tërë) por jo edhe i atyre të cilat i ka në posedim komuna ndikon në nënvlerësim të pasurive. Po ashtu, mungesa e harmonizimit të gjendjes së pasurisë së inventarizuar me atë të evidentuar në regjistrat e pasurisë rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen. Mangësitë e identifikuar reflektojnë edhe në paraqitjen jo të drejtë të pasurive në PFV.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që komuna ka në posedim. Kryetari, po ashtu duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit të inventarizimit, për harmonizimin e raportit të inventarizimit dhe regjistrave kontabël dhe komisionet e vlerësimit të krijohen në kohën e duhur me qëllim që gjendja e saktë e pasurisë të pasqyrohet drejt në PFV.

### **Çështja B3 - Mungesa e rregullave dhe procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë**

**Gjetja** Sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare përkatësisht neni 4, paragrafi 1 "Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare".

Komuna nuk ka hartuar ende rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë. Shkaku i mos inicimit dhe aprovimit të rregulloreve dhe procedurave të brendshme ishte neglizhenca e menaxhmentit përgjegjës.

**Ndikimi** Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejtë në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.

---

## 2.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Në këtë kapitull auditori ka trajtuar mbledhjen e të hyrave deri në 10€ dhe depozitimin e këtyre të hyrave në bankë.

---

### Çështja B4 - Depozitim i vonuar i parasë në bankë

**Gjetja** Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010, për të hyrat, citohet se: "Paratë e grumbulluara në vlerë deri në 10€ nga arkat e OB-ve në fund të ditës duhet të depozitohen (në llogari bankare zyrtare), total për çdo lloj të të hyrave me faturë përmbledhëse me numrin identifikues UNIREF". Komuna edhe në këtë vit, paratë e grumbulluara nga të hyrat nëpërmes arkës nuk i ka deponuar në llogarinë bankare me kohë. Parat e mbledhur prej datës 02.10.2019 deri me datën 29.11.2019 në vlerë prej 300€, janë deponuar në llogarinë e komunës me datë 02.12.2019 apo me 58 ditë vonesë.

Sipas zyrtarëve komunal një dukuri e tillë ndodhë për shkak se është e pamundur të bëhet depozitimi i mjeteve në baza ditore, si rezultat i mungesës së mjeteve të imta në arkë dhe mungesës së institucioneve financiare në komunë.

**Ndikimi** Mbajta e parasë në arkë mundëson keq përdorimin e parasë publike. Depozitimi i vonuar i të hyrave në llogarinë zyrtare reflekton edhe në raportimin jo të drejtë të të hyrave sipas periudhës kohore, sepse periudha e pranimi të parasë publike është e më hershme, krahasuar me periudhën e regjistrimit dhe raportimit të këtyre të hyrave.

**Rekomandimi B4** Kryetari të siguroj se do të zbatohen kërkesat ligjore për depozitimin me kohë të të hyrave të mbledhura nëpërmes arkës nga zyrtarët kompetent.

## 2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 154,844€. Kjo vlerë përbehet nga të hyrat e pa pranuar të tatimit në pronë në vlerë 104,886€ dhe taksës në firmë 49,958€.

### Çështja B5 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Komuna nuk ka një plan të përcaktuar në lidhje me inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga debitorët e saj. Komuna nuk kishte arrit të mbledhë taksën në firmë, në vlerë prej 51,794€, për 76 biznes të ngarkuar në vitet e mëparshme. Gjatë vitit 2019 vetëm dy biznese janë njoftuar dhe ngarkuar me taksë, përderisa vetëm njëra prej tyre kishte paguar borxhin në vlerë 2,040€. Pra në asnjë rast tjetër komuna nuk kishte ndërmarrë veprim konkrete, për të inkasuar të hyrat apo shtyrë debitorët për të përmbushur obligimin ndaj komunës.

Shkaku i një dukurie të tillë është mungesa e mekanizmave adekuatë nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra dhe kompetenca jo e mjaftueshme e stafit përgjegjës.

**Ndikimi** Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitorët mund të shkaktoj probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhet të inkasohen.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

## 2.5 Detyrimet

### 2.5.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 1,035€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

### 2.5.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 6,240€.

### 2.5.3 Detyrimet kontraktuale

Bazuar në informatat e marra nga zyrtarët përkatës për vitin 2019 Komuna e Mamushës nuk kishte detyrime kontraktuale.

## 2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB. Neni 5 pika 4 i rregullores nr 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik obligon OB të cilat nuk i plotësojnë kriteret për themelimin të AB të bëjnë kërkesë për auditim tek NjAB në MF deri në fund të muajit nëntor të çdo viti aktual.

Komuna me 24.10.2019 kishte parashtruar kërkesë për auditim të brendshëm drejtuar Njësisë për Auditim të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave. NjAB pran MF kishte pranuar kërkesën, mirëpo deri në përfundimin e auditimit nga ZKA, procesi i auditimit të brendshëm ende nuk ishte përfunduar.

## 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2018, për Komunën e Mamushës kishte rezultuar me 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar me vonesë raportin e parë të progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (me 14.02.2020), ku sipas kërkesave të Rregullores së Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, ky raport duhej ofruar me 30 shtator 2019. Komuna nuk ka arrit të dorëzoj raportin e dytë, i cili duhet të ofrohej me 15 mars 2020.

Deri në fund të auditimit për vitin 2019, katër rekomandime janë zbatuar, pesë nuk janë zbatuar ende dhe tre ishin rekomandime të mbyllura të pazbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të eliminuar dobësitë në klasifikimin e duhur të shpenzimeve të shpalosura në theksimin e çështjes të opinionit të auditimit.</p> <p>Gjithashtu kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe shpalosjen e drejt të pasurisë, të arkëtueshmeve dhe prezantimin e shpenzimeve. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Auditori ka identifikuar keq klasifikimit të shpenzimeve edhe këtë vit.	Rekomandim i pa zbatuar.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale të pronat të vlefshme për bazën e tatueshme si dhe duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren.	Komuna ka ndërmarra veprime për verifikim të pronave dhe zbritjen për banimin parësor.	Rekomandim i zbatuar.
3	Paga dhe Mëditje	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, që të hyrat të regjistrohen sipas kodeve ekonomike adekuate me qëllim të prezantimit të drejtë në përputhje me planin kontabël dhe natyrës që ato i takojnë.	Ky rekomandim do të rregullohet me ligjin e ri të pagave.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.



4	Paga dhe Mëditje	Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore, kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.	Auditori vlerëson se rekomandimi është zbatuar.	Rekomandim i zbatuar.
5	Subvencion e dhe Transfere	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një rregullore për procesin e subvencionimit të gjitha aktiviteteve, dhe e cila specifikon qartë kriteret për subvencionim dhe e njëjta të aprovet në Kuvend Komunal.	Komuna ka hartuar Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve e Nr. 01/003-19.	Rekomandim i zbatuar.
6	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që fillimisht projektet ekzekutive janë të qëndrueshme dhe të planifikuara mirë, në mënyrë që mos të lejohen tejkalime-ndryshime të pozicioneve të para masave paraprakisht të kontraktuara. Në të kundërtën çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës nëse paraprakisht nuk sigurohet miratimi nga menaxheri i prokurimit dhe ZKA.	Auditori vlerëson se komuna nuk ka ndërmarr veprimet për zbatim të këtij rekomandim.	Rekomandim i pa zbatuar.
7	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi, të siguroj një evidencë të saktë të inventarit, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit E-pasuria dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.	Komuna ka filluar me regjistrimin e pasurive mirëpo auditori vlerëson se në këtë fushë ka mangësi evidente.	Rekomandim i pa zbatuar.
8	Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Kryetari të sigurohet se kontrollet janë vendosur dhe funksionojnë bazuar në kërkesat ligjore dhe arkatarët apo zyrtarët kompetent që mbledhin paratë publik si të hyra ti depozitojnë brenda afateve të parapara ligjore.	Komuna ende nuk ka ndërmarr masa për zbatimin e rregullores	Rekomandim i pa zbatuar.



			financiare 03/2010.	
9	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Edhe këtë vit komuna nuk kishte aplikuar masa për zvogëlimin e LL.A.	Rekomandim i pa zbatuar.
10	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që faturat paguhen brenda afatit ligjor.	Komuna ka ndërmarr masa për zbatim.	Rekomandim i zbatuar.
11	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.	Kjo situatë është e pa zbatuar për shkak të ndryshimeve ligjore.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
12	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.	Komuna ka ndërmarr disa hapa duke përpiluar planin e rrezikut mirëpo nuk ka ndonjë plan konkret për menaxhimin e tij.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të behët ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e		

		kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.
2	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit respektohen të gjitha kriteret e vendosura në konkurs. Në të kundërtën, në mungesë të konkurrentëve të rishpallet konkursi.
3	Subvencion e dhe transfere	Kryetari duhet të siguroj që në thirrjet publike për subvencionimin e OJQ-ve të vendosen kriteret e përgjithshme obligative dhe të lidh kontrata me OJQ-të e përzgjedhura si përfituesi.
4	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para se të realizoj punimet për projektet të cilat shtrihen përgjatë parcelave të cilat janë nën pronësi private, të ndërmarr veprimet e duhura ligjore për shpronësimin e parcelave përkatëse të cilat komuna i sheh në interes të publikut.
5	Investime kapitale	Kryetari përmes Menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejohet inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv, gjithashtu nuk duhet të lejohen tejkalime-ndryshime të pozicioneve të paramasave paraprakisht të kontraktuara, sepse çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës.
6	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para marrjes së vendimit për bartje të shumave nga një projekt në tjetrin, duhet miratim paraprak nga Asambleja Komunale.
7	Pasuritë kapitale dhe jokatitale	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që komuna ka në posedim. Kryetari, po ashtu duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit të inventarizimit, për harmonizimin e raportit të inventarizimit dhe regjistrave kontabël dhe komisionet e vlerësimit të krijohen në kohën e duhur me qëllim që gjendja e saktë e pasurisë të pasqyrohet drejt në PFV.
8	Pasuritë kapitale dhe jokatitale	Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.
9	Trajtimi i parasë së gatshme	Kryetari të siguroj se do të zbatohen kërkesat ligjore për depozitimin me kohë të të hyrave të mbledhura nëpërmes arkës nga zyrtarët kompetent.
10	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 124-20
Tarih/Dt. 23.06.2020	



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Abdulhadi Krasniç  
Kryetar i Komunës,

Data: 23.06.2020, Mamushë

